

Fëmijët në Rrezik dhe Media

Analizë mbi mënyrën e paraqitjes në media të ngjarjeve ku janë të përfshirë fëmijët viktimë të dhunës dhe abuzimit.

25.11.2015

Në bazë të Ligjit 10347, datë 4.11.2010, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe rinisë është autoriteti që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është institucioni përgjegjës për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në vend.

Analiza e mëposhtme ka si qëllim të prezantojë parimet epërgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe përgjegjësitë e medias të cilat bazohen në burime të rëndësishme legjislative ndërkombëtare dhe kombëtare. Analiza është pasuruar me raste studimore me qëllim ilustrimin e këtyre parimeve dhe evidentimin e problematikave konkrete të etikës së medias si dhe të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve.

I. Parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësitë e mediave

Media, si pushteti i katërt, ka detyrimin për informimin sa më të drejtë, paraqitjen me vërtetësi të fakteve dhe ngjarjeve, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe parandalimin e fenomeneve të rënda për shoqërinë. Kujdesi për mënyrën e shfaqjes së lajmit duhet të jetë maksimal, sidomos kur në qendër të lajmit janë fëmijët.

Ekzistojnë disa *parime bazë* që mediat duhet të kenë në vëmendje dhe të respektojnë me rigorozitet gjatë punës së tyre. Këto parime janë bazë e të gjitha legjislacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që në fokus kanë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

- Parimi kryesor është interesi më i lartë i fëmijës, parim ky i cili sanksionohet në të gjitha konventat dhe legjislacionin mbi fëmijët dhe jo vetëm. Në çdo publikim media duhet të ketë në fokus interesin më të lartë të fëmijës.
- E drejta për tu mosdiskriminuar
- E drejta e jetës dhe e zhvillimit
- E drejta e fëmijës për tu dëgjuar
- Një tjetër parim është mbrojtja e privatësisë së fëmijës dhe respektimi i jetës private, familjare, banesës, e korrespondencës.
- Mbrojtja e fëmijës nga cënimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit.

Sipas Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve i rëndësishëm është edhe riaftësimi dhe riintegrimi në shoqëri i cdo fëmije i cili është viktimë e një ngjarje të rëndë.

Duke respektuarkëto parime të përgjithshme media vendoset në shërbim të fëmijëve.

Këto parime kryesore burojnë nga një numër konventash të cilat Shqipëria ka ratifikuar dhe ligjeve që janë hartuar nën frymën e këtyre parimeve. Burimet kryesore janë:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Konventa e Lanzarotes, Direktiva Nr 13 e vitit 2010 e Parlamentit European dhe Këshillit, Ligji Nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, Ligj Nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, Vendim Nr. 01, datë 27.01.2014 “Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, Vendim Nr. 01, datë 27.01.2014 “Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive”.

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual, e njohur ndryshe si *Konventa e Lanzarotes* është traktati i parë ndërkombëtar që detyron shtetet palë të kriminalizojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Bazuar në Konventën e Lanzarotes, media duhet të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave për të parandaluar shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve¹. Në këtë frymë, media në punën e saj ka detyrimin që përveç informimit të kontribuojë në parandalimin e fenomenit të abuzimit seksual të fëmijëve.

Gjithashtu Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Udhëzuesin¹ për “Rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, në një kapitull të veçantë ka cituar fëmijët si “subjektet më të

¹Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (Konventa e Lanzarotes) - Neni 8, 9 (http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2014/02/Konventa-e-Keshillit-te-Europes-Per-mbrojtjen-e-femijeve-nga-shfrytezimi-seksual-dhe-abuzimi-seksual-LanzaroteConvention_al.pdf)

prekshme dhe të pambrojtura ndaj rrezikut të cënimit të të drejtave të tyre themelore dhe në veçanti të drejtën e privatësisë.

Përgjegjësitë e Mediave

Një sërë përgjegjësish rrjedhin nga legjislacioni kombëtar por edhe nga Konventat ndërkombëtare (këto burime janë përmbledhur në seksionin e tretë të këtij dokumenti):

- ✓ Mediat kanë detyrimin e raportimit të të gjitha ngjarjeve që lidhen me fëmijët me vërtetësi dhe saktësi.
- ✓ Mediat duhet të ndalojnë transmetimin e programeve që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të fëmijëve
- ✓ Mediat në të gjitha programet e tyre, duhet të respektojnë me rigorozitet privatësinë e fëmijëve, si dhe të dhënat personale të të cilëve janë objekt i një mbrojtjeje të veçantë.
- ✓ Media duhet të shmangë çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, apo adresë të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.
- ✓ Nga ana e medias duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës.
- ✓ Kujdes duhet treguar edhe me raportimin e transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës.
- ✓ Pamjet apo imazhet e fëmijëve media duhet t'i marrë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë si dhe ato duhen marrë me dijeninë dhe pëlqimin e vetë fëmijës apo të prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi t'i jetë shpjeguar qëllimi.

Mënyra e shqyrtimit të ankesave nga Autoriteti Mediave Audiovizuale²

Institucioni i cili mbikëqyr dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e të gjitha masave të nevojshme, ndaj të gjitha atyre mediave të cilat transmetojnë në shkëlqje të parimeve kryesore të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor është Autoriteti Mediave Audiovizuale (AMA). Këshilli i Ankesave pranë AMA-së shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve, respektimin e të drejtave të njeriut, rregullat e etikës, fshehtësinë e jetës private dhemostransmetimin e programeve pornografike pa siguruar mbrojtjen e fëmijëve.

²Vendim Nr. 01, datë 27.01.2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive."

II. Raste studimore

Në kuadër të kësaj analize, është ndjekur pasqyrimi mediatik i disa rasteve konkrete që kanë të bëjnë kryesisht me fëmijë në situata rreziku. U monitorua me vëmendje mënyra se si media e ka publikuar rastin dhe u evidentuan faktet ku media nuk ka respektuar parimet etike dhe ka shkelur të drejtat e fëmijëve.

Monitorimi i mëposhtëm nuk duhet të konsiderohet i shteruar, pasi nuk janë monitoruar të gjitha mediat për arsye të mungesës së burimeve të nevojshme. Referimet në media specifike duhet të konsiderohen si shëmbuj, duke marrë parasysh se mund të ketë edhe media të tjera që kanë vepruar në mënyra të ngjashme.

Rasti 1

Një fëmijë 12 vjeçar nga fshati Kryekuq i Divjakës, është viktimë e abuzimit seksual nga mësuesi. Lajmi publikohet për herë të parë më datë 3 Qershor 2015.

Mediat audiovizive

Mediat audiovizive kanë paraqitur rastin me detaje. Televizioni **News 24, Vizion Plus, Top Chanel, Ora News** kanë paraqitur pamje të fshatit ku fëmija jeton, janë filmuar pamje të jashtme nga banesa e fëmijës, ku nga këto pamje shtëpia është plotësisht e identifikueshme. Televizioni **News 24, Ora News, A1 Report** kanë transmetuar pamje të shkollës së fëmijës, ambjente të klasës ku fëmija ka zhvilluar mësimin. Fëmija është bërë lehtësisht i identifikueshëm edhe sepse këto televizione kanë nxjerrë pamje të kopertinës së regjistrimit të klasës ku kjo kopertinë përmbante të dhëna si: emri i shkollës, fshati, klasa dhe emri i mësuesit.

Transmetimi i detajeve të tilla është në kundërshtim të plotë me parimet kryesore që media duhet të respektojë. Në radhë të parë është shkelur parimi bazë ai interesit më të lartë të fëmijës. Media në paraqitjen e një lajmi ku viktima është fëmija, në fokusin e saj duhet të ketë interesin më të lartë të tij dhe jo interesin e saj vetjak për të bërë një lajm më tërheqës për audiencë. Rasti i fëmijës në fjalë është treguar dhe shfaqur thuajse në detaje.

Kemi shkelje të nenit **39 të Konventës për Mbrojtjen e Fëmijës**, pasi media me transmetimin pa kujdes të lajmit, bëhet një faktor pengues për riintegrimin e fëmijës në shoqëri. Fëmija është bërë lehtësisht e identifikueshme, në bazë të shumë të dhënave personale që janë paraqitur për të dhe familjen e saj, kështu që ky fëmijë do ta ketë tepër të vështirë rehabilitimin në shoqëri.

Në televizione janë shfaqur detaje të jetës personale të vajzës. Janë shfaqur ambiente të jashtme të banesës së saj, ambiente të shkollës, emri i fshatit, janë shfaqur familjarë të vajzës të cilët tregojnë detaje të ngjarjes. Në këtë mënyrë vajza është bërë lehtësisht e identifikueshme dhe është shkelur privatësia e saj. Parim ky i sanksionuar në **Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Mediat dhe Kodin e Etikës**.

News 24, ka intervistuar gjyshen dhe një të afërme të fëmijës përpara banesës ku fëmija jeton duke i pyetur ato me detaje mbi ngjarjen, mënyrën si e kanë zbuluar dhe në çfarë gjendje është fëmija, për më tepër gjyshja dhe e afërmja janë shfaqur me fytyrën zbuluar. Ndërkohë **Ora News, Vizion Plus, Top Channel** kanë intervistuar gjyshen dhe të afërmen po në ambientet e jashtme të shtëpisë por ndryshe nga **News 24** fytyra e tyre është e mbuluar.

Mediat e shkruara³

Në lidhje me mediat e shkruara ekziston një kod etik i cili është një udhëzues për gazetarët. Ai nuk është detyrues. Ai gjithashtu parashikon të gjitha parimet e konfirmuara në Konvetën e të Drejtave të Fëmijëve dhe të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve. Në veçanti ky kod shprehet që gazetari mbron të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve duke përfshirë të drejtën e tyre për ruajtjen e jetës private dhe të dhënave personale.

Në lidhje me lajmin, gazeta **BalkanWeb** ka publikuar emrin e fshatit, të shkollës. Është intervistuar e afërmja e fëmijës, duke e shfaqur me emër dhe mbiemër, një deklaram i tillë mund të çojë në identifikimin e fëmijës. Në këtë rast kemi shkelje të parimit të ruajtjes të privatësisë së fëmijës.

Gjithashtu janë dhënë detaje mbi abuzimin, të cilat mund të ishin evituar pasi shkaktojnë ritraumatizim dhe riviktimizim të fëmijës. Sipas Kodit të Etikës gazetarët nuk mund të botojnë informacione të jetës private të një fëmije vetëm në rast se kjo është një domosdoshmëri e interesit publik.

Gazeta Panorama ka marrë edhe një dëshmi të nxënësve të klasës së fëmijës. Ato tregojnë detaje se mbi marrëdhënien e mësuesit me fëmijën. Gjithashtu është e botuar edhe dëshmia që i kanë marrë fëmijës, minutat e tmerrit që ndjente ajo dhe frikën për të treguar.

Gazeta Tema ka publikuar një dëshmi të fëmijës. Në bazë të Kodit Etik për mediat e shkruara gazetarët nuk duhet të intervistojnë fëmijët nën moshën 14 vjeç për çështje personale, në mungesë ose pa pëlqimin e prindërve, ose personave përgjegjës për fëmijën.

Gazeta Mapo, Dita, Tirana Observer e ka paraqitur lajmin duke mos publikuar të dhëna, foto të të afërmeve që mund të çojnë në identifikimin e vajzës, por është bërë publike emri i shkollës.

³ Vetëm një pjesë e këtyre mediave janë përfshirë

Rasti 2

Mediat kanë paraqitur rastin e dy motrave të arratisur nga shtëpia e tyre. Motrat akuzohen se kane djegur shtëpinë dhe kanë helmuar prindërit. Ndërkohë dy motrat akuzojnë familjarët për ushtrim të dhunës në mënyrë të vazhduar nga ana e prindërve.

Televizioni **News 24, Klan Tv, Abc News, Top Channel, Vizion Plus, A1 Report** kanë shfaqur të dy vajzat me gjeneralitete të plota si dhe imazhe të qarta të tyre, gjë e cila ka çuar automatikisht në identifikimin e dy fëmijëve, në kundërshtim të plotë kjo me parimin e interesit më të lartë të fëmijës si dhe me ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e jetës personale.

Ndërsa televizioni **Ora News** njëren nga vajzat, atë më të voglën e shfaq me fytyrën mbuluar, ndërsa vajza më e madhe e cila akoma nuk ka mbushur 18 vjeç shfaqet me gjeneralitete të plota dhe me figurë e zë.

Në të gjitha televizionet e lartpërmendura rasti paraqitet me detaje nga jeta private e vajzave; shfaqen pamje të banesës familjare si dhe informacione personale si fejesa e mëparshme e vajzës më të madhe, në shkelje kjo me mbrojtjen e të dhënave personale. Janë shfaqur intervistime të të afërmeve: nëna, babai, motra dhe halla. Në këtë mënyrë vajzat janë bërë lehtësisht të identifikueshme dhe është shkelur privatësia e tyre. Parim ky i sanksionuar në **Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Mediat dhe Kodin e Etikës**, ku sipas këtij të fundit kujdes duhet treguar edhe me raportimin e transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës.

Top Channel, Klan Tv, Abc News dhe News 24, Vizion Plus kanë shfaqur videot të cilat vetë vajzat kanë hedhur në You Tube, gjë e cila nuk është një domosdoshmëri, pasi kjo ka çuar në identifikimin e dy vajzave.

Cënim të dinjitetit përbën edhe shfaqja e imazheve të seancës gjyqësore dhe pamje të dy vajzave të prangosura, transmetim i cili është bërë nga të gjitha televizionet e përmendura më sipër.

Televizioni **A1 Report** ka shfaqur pamje të Qendrës për Viktimat e Dhunës në Familje, ku njëra nga motrat është strehuar me vendim gjykate, gjë e cila çënon jo vetëm interesin e fëmijës në fjalë, por edhe të viktimave të tjera që strehohen në qendër.

Mediat e shkruara gjithashtu, kanë publikuar lajmin ku vajzat janë të identifikuara me emër, mbiemër, me foto të tyre personale si dhe me foto nga seanca gjyqësore, duke mos respektuar elementët dhe parimet etike në lidhje me privatësin dhe interesin më të lartë për fëmijën. Përmendim **Gazeta Panorma, Shekulli, Mapo, Shqiptarja.com, Shqip, Tirana Observer, Telegraf, Dita.**

Rasti 3

Mediat e shkruara kanë pasqyruar lajmin e abuzimit seksual të një fëmije 5 vjeçar nga një fëmijë 14 vjeçar në Durrës. Lajmi publikohet për herë të parë më datë 6 shtator 2015.

Gazeta “**Panorama**”ka publikuar lajmin dhe një intervistë me nënën e vajzës. Është publikuar emri i nënës dhe është shfaqur një foto e nënës. Transmetimi i detajeve të tilla e bëjnë fëmijën lehtësisht të identifikueshme.Sipas Kodit të Etikës, gazetarët nuk mund të botojnë informacione të jetës private të një fëmije vetëm në rast se kjo është një domosdoshmëri e interesit publik.

Gazetat **Shqip, Ballkan Web,** e ka pasqyruar lajmin, duke respektuar rregullat dhe parimet etike. Emrat e femijeve janë publikuar me iniciale, pa dhënë detaje të tjera që mund të cojnë në identifikimin e rasteve.

Rasti 4

Mediat e shkruara kanë pasqyruar lajmin e një vajze 15 vjeçare nga Tirana, e cila është bërë viktimë e abuzimit seksual nga babai i saj. Lajmi publikohet për herë të parë më datë 20 nëntor 2015.

Gazeta“**Tema**”, ka publikuar emrin e plotë tëbabait të vajzës së abuzuar qëështë dhe abuzuesi.Gazeta “**Shekulli**”,përveç publikimit të emrit të babait abuzues, ka identifikuar nënën e vajzës me emër dhe mbiemër, ka publikuar foto të prindërve, por dhe të ambienteve të brendëshme të shtëpisë. Kjo bën të mundur identifikimin e vajzës, gjë që bie nëkundërshtim të plotë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privacisë së fëmijës. Në gazetën “**Panorama**” përveç publikimit të emrit të babait është identifikuar vendi ku ka ndodhur ngjarja, në Kodër Kamëz. Këto dy të dhëna bëjnë të mundur lehtësisht identifikimin e fëmijës duke shkelur privatësinë e saj të sanksionuar në**Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Mediat dhe Kodin e Etikës.**

Gazeta “**Shqiptarja.com**” ka botuar emrin e plotë të babait të vajzës duke bërë tëmundur identifikimin indirekt të vajzës. Gjithashtu është publikuar dhe rrëfimi që vajza ka bërë në polici që edhe pse citohet që është bërë në prani të psikologes, ka të dhëna sensitive për vajzën që mund të çënojnë moralin, dinjitetin e fëmijës.

Koha Jonë, ka publikuar inicialin e emrit, por ka vënë mbiemrin e babait, që gjithësesi e bën të identifikueshëm fëmijën.

III. Kuadri ligjor

Më poshtë paraqiten të cituara nene të veçanta nga Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar dhe një sërë ligjesh shqiptare që sanksionojnë mënyrën e pasqyrimin nga media të rasteve dhe çështjeve të fëmijëve.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 1

Të gjithë njerëzit linden të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore.

Neni 12

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

Neni 3

Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni 39

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Committee on the Rights of the Child Original: General comment No. 13

The right of the child to freedom from all forms of violence

Komiteti periodikisht publikon vetë komente të përgjithshme mbi çështjet kyçe që lidhen me interpretimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Komenti i përgjithshëm 13, mbi 'Mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës' I Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve, përcakton disa nga masat që shteti duhet të marrë për të mbrojtur fëmijët, duke përfshirë edhe në lidhje me median dhe teknologjitë.

- *Shtetet palë kanë detyrimin që (art.41/g) “Të garantojnë që i gjithë legjislacioni kombëtar tu japë fëmijëve mbrojtjen e duhur në lidhje me mediat dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.*

- *Ndër masat sociale që shtetet palë duhet të ndërmarrin për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve, është (art 43/ix) “Zhvillimi i udhëzimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga materialet dhe informacionet e prodhuara nga media që shkelin integritetin dhe dinjitetin e fëmijës, për eliminimin e gjuhës stigmatizuese apo diskriminuese, për parandalimin dhe ndalimin e shpërndarjes së informacioneve apo raporteve që kontribuojnë në riviktimizimin e fëmijës dhe për promovimin e metodave profesionale të hetimit gazetaresk bazuar në përdorimin e burimeve të ndryshme të cilat mund të shqyrtohen nga të gjitha palët e përfshira.”*

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (Konventa e Lanzarotes)

Neni 8

Masat për publikun e përgjithshëm

1. *Çdo palë do të nxisë ose kryejë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit drejtuar publikut të gjerë duke ofruar informacion për fenomenin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për masat parandaluese që mund të merren.*
2. *Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për parandalimin ose ndalimin e shpërndarjes së materialeve rreth veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.*

Neni 9

Pjesëmarrja e fëmijëve, e sektorit privat, e medias dhe e shoqërisë civile

[...]

2. *Çdo palë inkurajon sektorin privat, në veçanti sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, turizmin, industrinë e udhëtimit dhe sektorët bankarë dhe të financës, si dhe shoqërinë civile, të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave për të*

parandaluar shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve dhe për të zbatuar normat e brendshme nëpërmjet vetërregullimit ose bashkërregullimit.

3. Çdo palë inkurajon median të ofrojë informacionin e nevojshëm lidhur me të gjithë aspektet e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, brenda kuadrit të respektimit të pavarësisë së medias dhe lirisë së shtypit. [...]

Directive 2010/13/Eu of the European Parliament and of the Council

Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që transmetimet televizive nga ana e transmetuesit nuk përfshijnë ndonjë program që mund të dëmtojë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturit, me përjashtim kur është siguruar, duke zgjedhur kohën e transmetimit ose janë marrë masa teknike që të miturit normalisht nuk do të dëgjojnë apo të shohin transmetime të tilla.

Ligji Nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”

Neni 14

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cënimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshi brenda familjes, institucioneve të përkujdesjes shoqërore dhe të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, përfshi të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

Neni 21

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

Fëmija mbrohet nga çdo formë e:

- a) dhunës fizike dhe psikologjike;*
- b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues;*
- c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes;*
- ç) keqtrajtimit dhe braktisjes;*
- d) mospërfilljes dhe neglizhimit;*
- dh) shfrytëzimit dhe abuzimit;*
- e) dhunës seksuale.*

Ligj Nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë

Neni 46 (pika 2/a, c, ç, dh)

2. Kodi i transmetimit siguron që:

a) të gjitha lajmet e transmetuara të njoftohen dhe të paraqiten në mënyrë objektive dhe të paanshme;

c) OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik, që mund të nxisin vepra penale apo të cenojnë autoritetin e shtetit;

ç) në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos cenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit;

dh) në çështjet që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale të realizohet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve. OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale.

Vendim Nr. 01, datë 27.01.2014 “Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive”

Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Seksioni 2

E drejta për privatësi në transmetimet audiovizive

- OSHMA-të, në të gjitha programet e tyre, duhet të respektojnë me rigorozitet dhe përparësi të drejtat e privatësisë së të miturve, të dhënat personale të të cilëve janë objekt i një mbrojtjeje të veçantë.
- Transmetimi, publikimi dhe përhapja e detajeve, me çdo mjet, i lajmeve apo pamjeve që identifikojnë një të mitur të përfshirë në një krim është i ndaluar.

Seksioni 5

Fëmijët në transmetimet audiovizive

Zbatimi i një tërësie parimesh e rregullash, që i japin përparësi interesit të lartë të fëmijës e që vendosin në qendër fëmijën, është më se i domosdoshëm. Parime të tjera bazë janë garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi, luftimi i paragjykimeve, diskriminimit dhe stereotipeve në shoqëri, vërtetësia dhe saktësia e konfirmuar e raportimit të ngjarjeve që lidhen me fëmijët, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve si dhe parimi shumë i rëndësishëm që e vendos median në shërbim të fëmijëve.

Identifikimi i fëmijës

5.1 OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale.

5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare.

5.3 Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës.

5.4 Kujdes duhet treguar edhe me raportimin e transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës.

5.5 Pamjet apo imazhet e fëmijëve duhen marrë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë dhe kurdo që është e mundur, ato duhen marrë me dijeninë dhe pëlqimin e vetë fëmijës dhe në rast të kundërt ato duhen marrë me pëlqimin e prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi t'iu jetë shpjeguar qëllimi.

Më poshtë Kodi i Etikës rregullon edhe mënyrën dhe shqyrtimin e ankesave nga subjekte të ndryshme mbi shkeljet që mund të ketë bërë një OSHMA.

Seksioni 9

Këshilli i ankesave

- *Këshilli i Ankesave mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, për çdo subjekt veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Objekti i punës së Këshillit të ankesave përfshin sidomos respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.*
- *Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve, respektimin e të drejtave të njeriut, rregullat e etikës, fshehtësinë e jetës private, mostransmetimin programeve pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.*
- *Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të subjektit, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s masat përkatëse. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.*

Kodi i Etikës për mediat e shkruara

Fëmijët dhe njerëzit e dobët

- *Gazetari duhet të respektojë të gjitha parimet e konfirmuara në Konventën e OKB-së të vitit 1989 mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve.*
- *Gazetari mbron të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar.*
- *Gazetarët nuk duhet të përfitojnë nga pafajësia dhe besimi i fëmijëve dhe mund të botojnë informacione apo pamje të jetës private të një fëmije vetëm në rast se kjo është një domosdoshmëri e interesit publik.*
- *Gazetarët nuk duhet të intervistojnë fëmijët nën moshën 14 vjeç për çështje personale, në mungesë ose pa pëlqimin e prindërve, ose personave përgjegjës për fëmijën.*

¹ Shtuar me Udhëzimin Nr. 32, datë 27.12.2012